**VENDIM**
**Nr. 249, datë 24.4.2024**

# PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT, TË PRONËS ME EMËRTIM "AGJENCIA PETRELË", ME VENDNDODHJE NË PETRELË, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 413, DATË 11.7.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES (DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT)", TË NDRYSHUAR, SI DHE PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË SHTETIT, NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 2947, PJESË E PASURISË ME NR. 444/16

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Mbrojtjes te Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të pronës me emërtim "Agjencia Petrelë", me vendndodhje në Petrelë, Tiranë, zona kadastrale 2947, me numër pasurie 444/15, sipas planrilevimit në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ngritjen e një qendre social-kulturore, multifunksionale, rekreacioni dhe argëtimi, me emërtimin "Parku tematik kulturor "*Tirana Art Garden*"".

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit të pronës së paluajtshme të shtetit, ndodhur në zonën kadastrale 2947, pjesë e pasurisë me nr. 444/16, sipas planrilevimit në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ngritjen e një qendre social-kulturore, multifunksionale, rekreacioni dhe argëtimi, me emërtimin "Parku tematik kulturor "*Tirana Art Garden*"".

3. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 413, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit)", të ndryshuar.

4. Fondit Shqiptar të Zhvillimit i ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pronave të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, si dhe tjetërsimi i tyre.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

ANEKSI 1

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
## Prona (DPRMSH) "Agjencia Petrelë", Petrelë, Tiranë

PRONARI REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MM, (Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit) DATË 12/04/2024 QËLLIMI: Transferim nga MM te FSHZH

VENDNDODHJA
Bashkia Tiranë DVASHK Tiranë Nr.Pasurisë 444/15 Z.K 2947 Indeksi i Hartës K-34-100-(60-C)
TE DHËNAT E PASURISË
Lloi i pasurisë________ Sip e pasurisë 27 000 m² Sip. e gjurmës së ndërtimit 3335 m² Nr. kateve____ Nr. pemeve____

Nord = 4569150.57
East = 486880.76

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

Nord = 4569150.57
East = 487571.98




SHPJEGUESE:

Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.1 = 125m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.2 = 387.5m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.3 = 406.25m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.4 = 387.5m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.5 = 781.25m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.6 = 781.25m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.7 = 375m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.8 = 85m²
Sip. e gjurmës së ndërtimit të objektit nr.9 = 6.25m²
**Sip. e përgj. e gjurmës së ndërtimit të objekteve = 3335m²**
**Sip. përgj. e pronës = 27 000m²**
Kufiri sipas HTR dhe faktit

Nord = 4568517.91
East = 486880.7776

SH 1: 2500

Nord = 4568517.91
East = 487571.98

| NR | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI I KUFIRIT | KUFITARI | NIPT /IGJIU |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Veri | | | | K51726024H |
| 2 | Lindje | | | | |
| 3 | Jug | | | | |
| 4 | Perëndim | | | | |

REALIZOI PËR IGJIU
Specialist Ramiz Haxhiu

KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI MArch. Teuta **KANXHERI**

REALIZOI PËR ASHK
Specialisti________
DVASHK________
Nënshkrimi________
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori________
Nënshkrimi/ Vula________

TEKNOLOGJIA E MATJEVE Ortofoto 2015-2016, azhornimit në terren.
PËRCAKTIMI I KUFIRIT Sipas dokumentacionit hartografik arkivor marë në DPRMSH Agjencia Rajonale Tiranë.

Shënime : Ky planrilevim u hartua në zbatim të shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit nr.527/5, datë 09.04.2024 bazuar në dokumentacionin hartografik b/lidhur shkresës, dhe dokumentacionit HTR dhe kartela e pasurisë e dërguar elektronikisht nga ASHK me datë 12/04/2024.

PRONARI: REPUBLIKA E SHQIPËRISË MM, (Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit)

MIRATOHET
DREJTORI I PËRGJITHSHËM I REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT
Robert **HYSENLLARI**

ANEKSI 2

# PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE

**PRONARI: SHTET** | **DATË:** | **QËLLIMI:INVENTARIZIMI/REGJISTRIM**

**VENDNDODHJA:** PETRELE BASHKIA TIRANE DVASHK/ZVASHK TIRANE _______ ZONA KADASTRALE **2947** NR.PASURISË 444/16 INDEKS HARTE K-34-100-(60-C)

**TË DHËNAT E PASURISË:** LLOJI PASURISË -PA FRUT SIP. E PASURISË 37000$m^2$ SIP. E GJURMËS SË NDËRTIMIT =__ Nr.KATEVE ___ Nr.PEMËVE __

**X=4569001.9,Y= 487255.3** **KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE** **X=4568912.0, Y=487618.1**




**X=4568566.2, Y=487305.3** SHKALLA **1:2500** **X=4568858.5, 487873.9**

| Nr | ORIENTIMI | PËRDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHËNIME TË REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

***REALIZOI PËR SUBJEKT PRIVAT***

Emri: ***GEZIM SALJA***
Liçensa Nr. ***T.0066/4*** *Date.* 14.05.2018
Kompania: ***"GSA GROUP"***
Data e Pergatitjes: **19**.*04.2024*
Nënshkrimi/vula

***REALIZOI PËR ASHK***

SPECIALISTI ____________
DVASHK ___________
NËNSHKRIMI ________

***KONFIRMOI***

PËRGJEGJËS/DREJTORI ________ Gezim Salja
NËNSHKRIMI / VULA

Digitally signed by Gezim Salja
Date: 2024.04.19 14:03:15 +02'00'

***TEKNOLOGJIA E MATJEVE*** ______Z______
Kode për teknologjinë e matjeve: T - Terren; Z - Zyrë; O - Ortofoto; G - Gps; S - Stacion Total; D - Matje Distancash;

***PËRCAKTIMI I KUFIRIT*** __________
Kode për përcaktimin e kufirit: P - Përfaqësues i Pronarëve; K - Kufitarët të gjithë; KP - Kufitarët Pjesërisht; PB - Përfaqësues Bashkie; HK - Harta Kadastrale:

***SHËNIME TË VEÇANTA:***

***PRONARI/BASHKËPRONARËT - DEKLARIM MBI MARRËDHËNIET ME KUFITARËT***

EMRI GEZTIAN KE
NËNSHKRIMI__________

REPUBLIKA E SHQIPËRISË FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT TIRANË

Kode për teknologjinë e matjeve dhe përcaktimit e kufirit: T - Terren; Z - Zyrë; O - Ortofoto; G - Gps; S - Stacion Total; D - Matje Distancash; P - Përfaqësues i Pronarëve; K - Kufitarët të gjithë; KP - Kufitarët Pjesërisht; PB - Përfaqësues Bashkie; HK - Harta Kadastrale: